



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA CERRIK

(Zyra e Kryetarit Bashkise – tel. 0581 222 63 – fax 0581 223)

KONTRATE PER MBIKQYRJE PUNIMESH

(SUPERVIZION)

Objekti: “Mbikqyrja e Punimeve per Objektin “Rikonstruksion dhe ndertim I Palestres se Shkolles 9-vjecare ,7-Marsi Cerrik”

Ne mbeshtetje te Ligjit 7850, date 29.07.1994, Kodi Civil I Republikes se Shqiperise, Ligjit 8402, date 10.09.1998 “Per Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve ne ndertim”,UKM Nr. 3 date, 15.02.2001, “Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit” I ndryshuar UKM-ve Nr. 4, date, 17.05.2001, Nr,7 date. 21.11.2001, Nr 1, date. 22.02.2005, Nr.1 ,date 16.06.2011 dhe UKM Nr 2 Date 13.05.2005 “Per zbatimin e punimeve te ndertimit”, si dhe Proces-Verbalit te dates 18/06/2015 te Komosjonit te vlersimit te ofertaverit. Lidhet kontrata midis Paleve:

Bashkia Cerrik,perfaqesuar nga Titullari I Autoritetit Kontraktor,z. Servet Duzha,me detyre **Kryetar I Bashkise**,me poshte I quajtur Investitor.

dhe

Shoqeria“ERALD-G”regjistruar ne QKR me NIPT K36306784K dhe me license MK 1015/6,perfaqesuar **z.Gezim Selimi,Administrator**,(me poshte Mbikqyres I Punimeve,Supervizor).

Palet bien dakort per kushtet qe vijojne:


1. Mbikqyresi I Punimeve pergjigjet per realizimin pike per pike te kontrates se nenshkruar midis sipermarresit dhe investitorit per realizimin e fazave te ndryshme te zbatimit te respektimit te afatit te dorezimit dhe koston se objektit.
2. Mbikqyresi I Punimeve pergjigjet per ndertimin e objektit ne perputhje me projektin dhe kushtet teknike te zbatimit ne fuqi,per mbikqyrjen dhe pershkrimin e zbatimit te projektit,cilesine e materialeve te perdorura qe te plotesojne kerkesat e objektit si dhe per vendosjen ne veper te elementeve te parapergatitura.
3. Mbikqyresi I Punimeve vihet ne dijeni nga investitori per nenkontraktoret e mundshem qe zgjedh sipermarresi,ne perputhje me kontraten e nenshkruar.
4. Te gjitha dokumentat e percaktuara ne ligjin nr. 8402 Dt. 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit te ndryshuar” qe sipermarresi do te depozitoje ne Bashkine Cerrik,si dhe libri I kantjerit,duhet te jete e firmosur nga Mbikqyresi I Punimeve.




5. Mbikqyresi I Punimeve gjate zbatimit te objektit ngarkohet ti jape instruksione dhe urdhera me shkrim sipermarresit,sa here qe e sheh te nevojshme dhe sipermarresi eshte I detyruar ti zbatoje ato.Ky I fundit ka te drejte te beje me shkrim verejtjet e tij lidhur me instruksionet dhe urdherat e drejtorit te punimeve.
6. Mbikqyresi I punimeve ka te drejten qe me miratimin e investitorit te jape urdhera me shkrim per ndryshimet qe ai I sheh te arsyeshme qe duhen bere gjate zbatimit te vepres.Ne raste urgjente Mbikqyresi u Punimeve mund te urdheroje me shkrim zbatimin e menjehershem te ndryshimeve.
7. Mbikqyresi I Punimeve ka te drejte te kerkoje largimin nga puna te drejtuesit te kantjerit ose specialisteve te vecante per mosbindje,paaftesi ose pakujdesi te rende.
8. Materialet qe do te perdoren ne veper duhet te jene ne perputhje me kerkesat e kontrates.Ato mund te perdoren ne veper vetem me miratimin e Mbikqyresit te Punimeve.Materialet e ardhura ne kantjer qe nuk pranohen nga Mbikqyresi I Punimeve,zevendesohen me material te tjera me shpenzimet e Sipermarresit.
9. Mbikqyresi I Punimeve ka te drejte te vendosi te beje prova te materialeve per te verifikuar cilesine e tyre.Shpenzimet per keto prova jane ne ngarkim te Sipermarresit.
10. Kur Mbikqyresi I Punimeve mendon se ka defekte ne konstruksione apo ne pjese te tjera te vepres,kerkon te behen verifikimet perkatese.Kur verifikimet I japin te drejte drejtorit te punimeve shpenzimet jane ne ngarkim te Sipermarresit ne rast te kundert sipermarresi ka te drejte te kerkoje shlyerjen e shpenzimeve.
11. Kur urdherohet nga Mbikqyresi I Punimeve,sipermarresi duhet te prishe dhe ribeje me shpenzimet e veta punimet e bera jo me cilesine e parashikuar ose me materiale sipas pershkrimeve te projektit dhe standarteve ne fuqi.
12. Mbikqyresi I Punimeve ka te drejte te pezulloje perkohesisht punimet kur gjykon se ka shkaqe per kete.Kjo nderprerje nuk duhet te zgjase me shume se 1/3 e kohezgjatjes se punimeve sipas kontrates se nenshkruar,por ne cdo rast jo me shume se 6 muaj.
13. Sipermarresi duhet ti njoftoje me shkrim Mbikqyresit te Punimeve perfundimin e punimeve,me kete rast ai I paraqet Atij dokumentat e meposhtem:
 - Kontraten dhe aktet e tjera qe lidhen me to.
 - Procesverbalet e dhenies,nderprerjes,zgjatjes para dhe pas perfundimit te punimeve.
 - Kerkesat e tij.
14. Mbikqyresi I Punimeve duhet ti paraqese Investitorit materialet e sipershenuara te dorezuara nga sipermarresi se bashku me relacionin e vet.



(Handwritten signature)




15. Ne perfundimin e punimeve, brenda 30 diteve Mbikqyresi I Punimeve duhet te depozitoje tek Investitori, ne nje relacion ne kater kopje, rreth zbatimit te punimeve me karakteristikat dhe cilesine e materialeve te perdoruara ne veper duke paraqitur:
- Certifikatat e provave te materialeve te perdoruara leshuar nga labororet e autorizuar per kete qellim.
 - Per ndertimet e permendura cdo te dhene per plotesimin ne veper te kesaj strukture.
 - Perfundimet e provave eventuale nen ngarkese duke bashkalidhur aktet e mbajtura per kete qellim.
 - Deklarata qe objekti eshte zbatuar ne perputhje me projekt zbatimin dhe kushtet teknike, si dhe cdo dokument qe kerkon ligji nr 8402 Dt. 10.09.1998.
 - Per pikat e mesiperme Mbikqyresi I Punimeve duhet te firmose gjithcka qe eshte miratuar prej tij dhe mban pergjegjesi ligjore se bashke me Sipermarresin.
 - Njera nga dy kopjet, e konfirmuar nga Mbikqyresi I Punimeve I dergohet Kolaudatorit.
16. Mbikqyresi I Punimeve asiston ne kolaudimin e vepres I pergjigjet kolaudatorit per te gjitha dokumentacionin e nevojshem gjate kolaudimit te vepres dhe firmos procesverbalin e kolaudimit.
17. Mbikqyresi I Punimeve eshte pergjegjes per fondin e vepres. Situacionet e paraqitura nga sipermarresi pas kryerjes se punimeve ne faza te ndryshme mund te paguhen nga Investitori vetem pasi te jene shqyrtuar dhe firmosur nga Mbikqyresi I Punimeve.
18. Mbikqyresi I Punimeve kontrollon perdorimin e fondit rezerve dhe I raporton Investitorit. Ky I fundit nese ka objeksion njofton Kontraktuesin dhe problemi zgjidhet midis tyre. Per cdo ndryshim te mundshem Mbikqyresi I Punimeve vihen ne dijeni per te ndjekur zbatimin e ndryshime te miratuara nga Investitori. Mbikqyresi I Punimeve ka per detyre dhe pergjigjet per hartimin e situacionit progresiv dhe perfundimtare te punimeve te kryera nga kontratori, per saktesine e tij, dhe pasi nenshkruhet prej behet pagesa per vleren financiare perkatese.
19. Ne fund te punimeve Mbikqyresi I Punimeve nxjerr per Investitorin dhe per Sipermarresin nje vertetim final pagese, ku shpallet shuma finale e detyrueshme sipas Kontrates.
20. Mbikqyresi I Punimeve eshte I detyruar te mbaje regjistrimin e te dhenave financiare te te gjitha pagesave dhe te kosos se projektit dhe ti perfshije ato ne raportet mujore.
21. Mbikqyresi I Punimeve duhet te vihet ne dijeni per nenkontratore te mundshem qe zgjedh sipermarresi ne perputhje me kontraten e nenshkruar.
22. Mbikqyresi I Punimeve duhet te ofroje asistence Kontraktorit per probleme qe kane te bejne me interpretimin e dokumentave, kontrollit topografik te terrenit, kontrollin e cilesise, kryerjen e provave dhe ceshtjeve te tjera qe lidhen me detyrimet kontraktuale. Ai vene ne dispozicion kontraktorit dokumentacionin teknik e ligjor dhe merr pjese ne kolaudimin e objektit dhe ne procesin e marjes ne dorezim nga autoriteti kontrator.



23. Mbikqyresi I Punimeve nuk duhet te kete lidhje pune,gjaku apo interesash as me sipermarresin dhe as me kolaudatorin,ne te kundert ai nuk ka asnje pengese te ketij lloji me projektuesin.Kjo behet me ane te nje deklarate me shkrim qe Mbikqyresi I Punimeve I ben Investitorit.
24. Kur verehen shkelje te dispozitave ligjore Investitori ka te drejte te urdheroje Mbikqyresin e Punimeve per pezullimin e punimeve.
25. Kur shkeljet e dispozitave ligjore nuk perbejne veper penale denohen me gjobe nga 1.000 deri 100.000 leke sipas ligjit 8402 Dt. 10.09.1998, "Per kontrollin dhe disiplinimin e ndertimeve".Ne rast se Mbikqyresi I Punimeve kryen shkelje financiare dhe penale pergjigjet perpara ligjeve ne fuqi.
26. Subjekti "ERALD-G" Sh.P.K i caktuar per Mbikqyrjen e Punimeve per kohen e punes qe eshte ne dispozicion te Investitorit paguhet prej tije me shumen **862800 leke**(Teteqindeegjashtedhjeteedymijeteqinde) lek me TVSH, vlere e percaktuar ne Oferten eparaqitur nga Mbikqyresi I punimeve ,vene ne dispozicion nga Investitori.
27. Kerkesa per pagese duhet ti behet Autoritetit Kontraktor me shkrim. Per cdo pagese,kontraktuesi duhet te paraqese preventivin e mbikqyrjes te dale si rezultat I perqindjes se realizimit te punimeve ne objekt si dhe raportit mujore te punimeve.Pagesa duhet te behet brenda 30 diteve kalendarike nga dita qe ka kryer sherbimet,kur dorezimi eshte paraqitur ose arritur,ose nga data e marrjes se kerkeses me shkrim per pagese cilado te jete me vone.
28. Mbikqyresi I Punimeve gjate gjithë veprimtarise duhet te zbatoje te gjitha kerkesat dhe detyrimet qe rrjedhin nga ligji nr. 8402 dt. 10.09.1998 si dhe te udhezimit Nr.3 date. 15.02.2001 , "Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit", I ndryshuar UKM-ve Nr. 4,date. 17.05.2001, Nr.7, date . 21.11.2001, Nr. 1, date. 22.02.2005, Nr.1, date 16.06.2011 si dhe akteve te tjera ligjore dhe nenligjore ne fuqi,gjithashtu mban pergjegjesi sipas dispozitave ligjore ne fuqi per mos respektimin e tyre.
29. Per cdo mosmarreshje palet mund te merren vesh miqesisht ne te kundert ato I drejtohen Gjykates se Rrethit Gjyqesor Elbbasan per zgjidhjen e ketyre mosmarreshjeve.
- Kjo kontrate hartohet ne 5(pese)kopje nga te cilat,nje e mban Mbikqyresi I Punimeve dhe kopjet e tjera Investitori.

MBIKQYRESI I PUNIMEVE
ERALD- G
Gezim ISLAMI



INVESTITORI
Bashkia Cerrik
Servet DUZHA